



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. 49 / \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

**Shtojca 12**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT PARAPRAK**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

[21.04.2022]

Drejtuar: **AGRI CONSTRUCTION shpk me NIPT K01725001F dhe adresë "Tiranë DIBRES-ISH.TRUP.SHK.SKENDERBEJ 3"**

Procedura e prokurimit/lotit: e hapur - prokurim me mjete elektronike – punë publike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-20266-02-22-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **"Rikonstrukcion i godinës së Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut Tiranë"** me fond limit **158,972,395.02** (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë pesë.02) **Lekë pa TVSH.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): **Nuk ka**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. BOE: 2 N shpk me NIPT L31615017L dhe adresë Tiranë Paskuqan PASKUQAN Lagjja "Paskuqan Fushe", Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2, Kati i Pare, & GLAVENICA shpk me NIPT K17710805A dhe adresë Fier Ballsh BALLSH Lagjja "5 Shkurti", Bulevardi "4**

Heronjtë", godina nr.2, apartament nr.3, kati.4. **si dhe BEAN shpk me NIPT J72510445Q** dhe adresë Fier Levan LEVAN Lagjja Qender, prane shkolles 8 vjeçare, (përfaqësues i BOE me prokurë 2 N shpk)  
me vlerë 101,532,583.00 lekë pa tvsh

2. **PEPA GROUP shpk me NIPT L42215009L** dhe me adresë Tiranë Kashar Autostrada Tiranë Durrës km 6, Zona Kadastrale nr.2105, Nr Pasurie 1168/13,  
me vlerë 106,015,072.77 lekë pa tvsh
3. **BOE: DAJTI PARK 2007 shpk me NIPT K11507003S** dhe me adresë Tiranë Rruga Bardhok Biba, Pallati TREMA, Hyrja C, KODI POSTAR 1016 **si dhe ALTEC shpk me NIPT K57923807W** dhe me adresë Fier Ballsh "Mallakaster", Njesia Administrative "Fratar", Fshati "Ninesh", Rruga "Qender", Godina Nr.15, **përfaqësues i BOE me prokurë DAJTI PARK 2007 shpk,**  
me vlerë 108,894,476.41 lekë pa tvsh
4. **S I R E T A 2F shpk me NIPT K51501008J** me adresë Tiranë Paskuqan Lagjja Babrru Fushe, Komuna Paskuqan  
me vlerë 110,185,185.00 lekë pa tvsh
5. **BOE: Braka Construction shpk me NIPT L61906505I** dhe adresë Durrës Ndertim objekt multifunksional 10 katesh, 8 kate banim + 2 sherbimi dhe 1 kat nentoke, lagjja Nr.5, Rr.Hajdar Dushi, ish Parku Sportiv, përballë shkollës Marie Kaçulini, ndodhur ne kryqezimin e rruges Mujo Ulqinaku me rrugen Andon Naçi dhe Hajdar Dushi **si dhe SARDO shpk me NIPT K13120402W** dhe adresë Fier Lagjja Apollonia, Rruga Jakov Mile, Z. Kadastrale 8534, Nr. Pasurise 3/5-N12., **përfaqësues i BOE me prokurë Braka Construction,**  
me vlerë 110,979,311.49 lekë pa tvsh
6. **KEVIN KONSTRUKSION shpk me NIPT K71401004W** dhe me adresë Tiranë Rruga Adem Jashari, Ndertesa 4, Hyrja 10, Njesia Bashkiake Nr.5,  
me vlerë 113,243,735.40 lekë pa tvsh,
7. **AGRI Construction shpk me NIPT K01725001F** dhe me adresë Tiranë DIBRES-ISH.TRUP.SHK.SKENDERBEJ 3,  
me vlerë 116,869,692.40 lekë pa tvsh me vlerë të korigjuar, 114,562,775.73 lekë pa tvsh.
8. **Euro ndertimi 2000 shpk me NIPT K02003001O** dhe me adresë Tiranë Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, Pallati 114, Shkalla 1, Kati 2, Apartamenti 2,  
me vlerë 118,426,442.00 lekë pa tvsh,
9. **INERTI shpk me NIPT J66926804L** dhe me adresë Elbasan Gramsh L. SPORTI,  
me vlerë 121,891,117.75 lekë pa tvsh,
10. **BOE: NDERTIMI shpk me NIPT K11325002C** dhe me adresë Tiranë Rruga e Durrësit, Apartamenti Nr.3, Zona Kadastrale Nr.8310, Numër Pasurie 10/178/ND+1-3, (Zyrë), Tiranë

dhe **XHENGO shpk me NIPT J64103171M** dhe me adresë Korçë DON. GJON. BUZUKU, L.5, **përfaqësues i BOE me prokurë NDERTIMI shpk**, me vlerë 122,726,817.00 lekë pa tvsh,

11. **NIKA me NIPT J76705047U** dhe me adresë Shkodër Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”, me vlerë 123,298,546.49 lekë pa tvsh,
12. **BOE: MODESTE shpk me NIPT J62903413B** dhe me adresë Fier L. 1 MAJ 15 dhe **ARKONSTUDIO shpk me NIPT L42019004I** dhe me adresë Tiranë Rruga Mihal Duri, Objekti Nr. 33, **përfaqësues i BOE me prokurë MODESTE shpk**, me vlerë 127,204,079.10 lekë pa tvsh
13. **ED Konstruksion shpk me NIPT K61625001I** dhe me adresë Tiranë Rruga "Abdi Toptani", Qendra "Torre Drin", apartamenti 112, kati 11, me vlerë 131,940,465.25 lekë pa tvsh
14. **DION-AL shpk me NIPT K67917301H** dhe me adresë Tiranë Bulevardi "Gjergj Fishta", kulla 2, kati 2, me vlerë 137,331,311.40 lekë pa tvsh me vlerë të korigjuar 131,744,111.4 lekë pa tvsh,
15. **BOE: AURORA shpk me NIPT K02017003I** dhe me adresë Tiranë Bulevardi Zogu i Pare, Pallati prane Fakultetit te Shkencave, Tiranë si dhe **S. A G shpk me NIPT K51802003G** dhe me adresë Tiranë Njesia bashkiake nr 5, rruga Asim Zeneli, pallati S.A.G nr 1, kati 2, nr 7, **përfaqësues i BOE me prokurë AURORA KONSTRUKSION shpk**, me vlerë 137,999,005.00 lekë pa tvsh
16. **NDERTIM MONTIMI PATOS sh.a me NIPT J63229454K** dhe me adresë Fier Patos Rruga Nacionale Fier-Patos, Km.7, Lagjja "Zona Industriale Transport", Ndertese private Nr.123, me vlerë 158,341,087.48 lekë pa tvsh
17. **Eduart Çela, Person Fizik, me NIPT M03806202I** dhe me adresë Durrës Kruje Qender, ndertese private, 1 kateshe, zona kadastrale nr. 8621, me numer pasurie 5/541N, pa ofertë ekonomike
18. **MAKHES ALBANIA, E Thjeshtë, me NIPT K81316048R** dhe me adresë Tiranë Njësia Bashkiake Nr.11, Rruga Dritan Hoxha, Godina Nr.203, Hyrja Nr.15, Pallati MC Inerte, Laprakë, pa ofertë ekonomike

\*\*\*

Nga pjesërmarrësit, janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. **BOE: 2 N shpk me NIPT L31615017L** dhe adresë Tiranë Paskuqan PASKUQAN Lagjja "Paskuqan Fushe", Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2, Kati i Pare, **GLAVENICA shpk me NIPT K17710805A** dhe adresë Fier Ballsh BALLSH Lagjja "5 Shkurti", Bulevardi "4 Heronjtë", godina

nr.2, apartament nr.3, kati.4. si dhe BEAN shpk me NIPT J72510445Q dhe adresë Fier Levan LEVAN Lagjja Qender, prane shkolles 8 vjecare, përfaqësues i BOE me prokurë 2 N me vlerë 101,532,583.00 lekë pa tvsh

### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- I.** Në kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar paraqitja e sigurimit të ofertës, ku në DT kërkohej më një kohëzgjatje prej 180 ditë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE rezulton se siguri i ofertës nuk është bërë për 180 ditë sikurse është kërkuar në DT por për 150 ditë.

Kjo në kundërshtim më pikën: **3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës** të DST dhe në kundërshtim me pikën 3 të Nenit 30 Sigurimi i ofertës të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, e cila citon:

*3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.*

### **II. Në pikën 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar të DST përcaktohet:**

*1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

Operatori ekonomik 2N, sipas përqindjes së pjesëmarrjes, duhet të kishte, një nga tre vitet e fundit, një xhiro minimale të kërkuar prej  $158,972,395.02 \times 0.44 = 69,947,853.81$  lekë.

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se vërtetimi i xhirove për tre vitet e fundit ky operator xhiron maksimale e ka në vitin 2019 në vlerën **66,665,157 lekë**. Për rrjedhojë ky operator nuk arrin të plotësojë kriterin 2.2 të DT.

- III.** Në zbatim të pikës 2.3.1 të DT përcaktohet se operatori me përqindjen më të lartë duhet të ketë një punë të ngjashme sa 50% e fondit limit të procedurës ndërsa anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik BEAN ka paraqitur dokumentacion për kontratat:

Nr	Emërtimi dokumentit	Numër kontrate	Datë kontratë	Vlera
1	BEAN_Pune_e_Ngjashme_Albpetro_3	12653/11	06.05.2019	18,645,301.00
2	BEAN_Pune_e_ngjashme_EKS_Sarande	20	21.12.2015	330,577,453.0
3	BEAN_PUNE_TE_NGJASHME_SHK OLLA_LIBOFSHE	3881/8	26.08.2019	20,624,049.0

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur për plotësimin e këtij kriteri, KVO vëren se: dokumentacioni i paraqitur për punën e ngjashme (dokumenti në SPE **BEAN\_Pune\_e\_Ngjashme\_Albpetro\_3.pdf**) sipas preventivit të paraqitur është vetëm *ndërtim tubacioni* e për rrjedhojë nuk do të meret parasysh në perlllogaritjen e kontratave të ngjashme.

Dokumentacioni i paraqitur për punën e ngjashme (dokumenti në SPE **BEAN\_Pune\_e\_ngjashme\_EKS\_Sarande.pdf**) sipas kontratës, nenit **3. Afati I kontratës**, kjo kontratë përfundon 13 (trembëdhjetë) muaj nga momenti i nënshkimit të kontratës. Kontrata për këtë punë është lidhur më datë **21.12.2015** dhe sipas **nenit 3. Afati I kontratës**, kjo punë ka përfunduar më datë 21.02.2017 (pas 13 muajsh) datë e cila nuk përfshihet në 5 vitet e fundit nga publikimi I njoftimit të kontratës për këtë procedurë. Për rrjedhojë edhe kjo punë nuk meret parasysh.

Operatori BEAN sipas % së pjesëmarrjes në BOE, duhet të kishte realizuar punë të ngjashme në 5 vitet e fundit një total prej **317'944'790.04 x 22.7% = 88,070,706.84 lekë**.

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton që, ky operator ka realizuar një shumë prej **20,624,049.0 leke**. Për rrjedhojë ky operator nuk plotëson kriterin **2.3.I** të DT.

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik” neni 92 pika 3:

**3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.**

Për sa më sipër oferta e **BOE 2N shpk +Bean shpk +Glavenica shpk** nuk kualifikohet.

2. **PEPA GROUP shpk me NIPT L42215009L** dhe me adresë Tiranë Kashar Autostrada Tiranë Durrës km 6, Zona Kadastrale nr.2105, Nr Pasurie 1168/13, me vlerë 106,015,072.77 lekë pa tvsh

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- I. Në preventivin e paraqitur nga ky operator ka një ndryshim volumi përkatësisht në vlerën e volumit të mëposhtëm nga vlera 2'610 kg në vlerën 2'600 kg:

Nr Anal	EMERTIMI I PUNIMEVE	Njësia	Sasia
An.4/m	F.V kanale ajri-llamarine zingato, me flanaxha etj $\delta = (0.6-1)mm$	kg	2,610.00

Ndryshimi i zërit në preventive e bën ofertën e këtij operatori të pa krahasueshme dhe të pamundur në vendosje në kushte të barabarta me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Kjo në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni2 pika d:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, ndaj dhe të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre në përputhje me këto dokumenta. Sasia është një element i rëndësishëm i preventivit të ofertës ekonomik për procedurën objekt prokurimi, përveç faktit që është një element i detyrueshëm i përcaktuar në DST nga autoriteti kontraktor, modifikimi i tij përbën mospërgatitjen e ofertës sipas përcaktimeve të dhëna në dokumentat e tenderit, duke e kthyer ofertën ekonomike në një ofertë të pavlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në

dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Këtë gjykim KVO e bazon dhe në vendimin e KPP i cili është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat, ankandeve publike dhe procedurave konkurruese të dhënies së lejeve minerare, organ i krijuar me ligjin 10 170, datë 22.10.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”.

### **K.P.P. 550/2020**

- II.** Për pajisjet e kriterit **2.3.10.** përcaktuar në DT përkatësisht për zërat 9, 10, 11 është deklaruar dhe ka autorizim nga Invertor A.G.S.A ndërsa katalogu i paraqitur është nga prodhuesi GR Albania për të cilin nuk ka autorizim.
- III.** Po për këto zëra ka një mospërputhje të vlerave të katalogut në atë të përkthyer. Sipas përkthimit, vlerat janë identik me kërkesat në DST, ndërsa ato në katalog janë ndryshe (shiko tabelën e mëposhtme).

Nr.	Modeli deklaruar	Të dhënat në katalog		Të dhënat në përkthim		Kërkuar në DT	
		Dimensionet	Fuqia (W)	Dimensionet	Fuqia (W)	Dimensionet	Fuqia (W)
9	RGR200-H-LL-S	1260x1500x550	2x370	1230x1700x490	2x350	1230x1700x490	2x350
10	RGR230-H-LL-S	1260x1595x600	2x370	1230x1700x490	2x350	1230x1700x490	2x350
11	RGR100-H-LL-S	1010x1260x500	2x150	860x1150x385	2x147	860x1150x385	2x147

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik” neni 92 pika 3:

**3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.**

Për sa më lart oferta e operatorit ekonomik **PEPA GROUP shpk** nuk kualifikohet

3. **BOE DAJTI PARK 2007 shpk me NIPT K11507003S** dhe me adresë Tiranë Rruga Bardhok Biba, Pallati TREMA, Hyrja C, KODI POSTAR 1016 **si dhe ALTEC shpk me NIPT K57923807W** dhe me adresë Fier Ballsh "Mallakaster", Njesia Administrative "Fratar", Fshati "Ninesh", Rruga "Qender", Godina Nr.15, **përfaqësues i BOE me prokurë DAJTI PARK 2007 shpk** me vlerë 108,894,476.41 lekë pa tvsh.

#### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- I. Nga dokumentacioni i ngarkuar ne SEP rezulton se sigurimi i ofertës është paraqitur vetëm në emër të operatorit Dajti Park dhe sigurimi i ofertës nuk specifikon pjesëmarrjen në BOE.

Kjo në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, pika 2 kreu XI, KUSHTE TË PËRGJITHSHME PËR ZBATIM, Neni 88:

*2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. **Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.***

- II. Dajti Park ka paraqitur dokumentacion për të vërtetuar punët e ngjashme ku ndër të tjera është edhe kontrata 1328 REP, 324/1 Kol, datë 19.04.2019, me vlerë 130,307,388.00, Leke me TVSH ( Dajti-Park-Kontrata-Ngjashme-Pallati.pdf) .

Në DT përcaktohet:

#### **2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me **sektorin privat**, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
  - Fatura tatimore perkatëse.

Për këtë punë nuk janë plotësuar kërkesat e vendosura ne DT pasi në dokumentacionin e paraqitur mungon:



- a. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
- b. Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim

Për rrjedhojë kjo punë nuk meret parasysh për përmbushjen e kriterit.

Për sa kohë operatori me % më të lartë në BOE nuk ka një punë të ngjashme sa 50% e fondit limit atëherë ai duhet të plotësojë, sipas % së pjesëmarrjes 2 fishin e fondit limit, pra një vlerë prej:

**317,944,790.00 x 0.72= 228,920,248.80 lekë**

Nga dokumentacioni i paraqitur shuma e punëve të ngjashme të operatorit Dajti Park është:  
**148,206,144.14 lekë.**

Për sa më lart operatori ekonomik nuk plotëson kushtin e punëve të ngjashme.

- III.** Nga verifikimet rezulton se, drejtuesi teknik i deklaruar nga operatori Dajti Park, z. **H. Shehu** rezulton i dypunësuar, pasi rezulton i punësuar në kompaninë MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE me NIPT K81314023A me objekt veprimtarie: .....*Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore deri ne 5 kate. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore mbi 5 kate, Rikonstruksione.....*

Kjo në kundërshtim me vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”, KREU IV Drejtuesi Teknik i Shoqërisë dhe Papajtueshmëria me Këtë Detyrë,

2. *Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit **Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike.***

***Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit***

Kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

- IV.** Operatori ekonomik Altech shpk, sipas ndarjeve të punës sipas kontratës së bashkëpunimit, ka marë përsipër në të tjera edhe punime:

#### **B.1. KABINA ELEKTRIKE**

#### **B.2. INSTALIMI ELEKTRIK OBJEKTI**

**B.7. MONTIM PAJISJE**  
**C.1. SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJE/2,**  
**etj.**

Sipas shtojcës së paraqitur nga ky operator, është deklaruar vetëm inxhinieri Mekanik.  
Nga zërat e marë përsipër për të realizuar, operatori ekonomik Altech shpk duhet të kishtë edhe:

- Inxhinier H/teknik
- Inxhinier Elektrik

Për sa më lart OE Altech shpk nuk plotëson kriterin 2.3.5 të DT.

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik” neni 92 pika 3:

**3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.**

Për sa më sipër oferta e BOE **Dajti Park 2007 shpk & Altec shpk** nuk kualifikohet.

-----

- 4. S I R E T A 2F shpk me NIPT K51501008J me adresë Tiranë Paskuqan Lagjia Babrru Fushe, Komuna Paskuqan me vlerë 110,185,185.00 lekë pa tvsh**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- I.** Në preventivin e paraqitur nga ky operator ka një ndryshim volumi përkatësisht në vlerën e volumit nga vlera 0.002 ton në vlerën 0.00 ton.

<b>Nr Anal</b>	<b>EMERTIMI I PUNIMEVE</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
<b>4.164</b>	<b>F.V konstruksione te vogla elektrike</b>	<b>ton</b>	<b>0.002</b>

Ndryshimi i zërit në preventive e bën ofertën e këtij operatori të pa krahasueshme dhe të pamundur në vendosje në kushte të barabarta me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Kjo në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni2 pika d:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, ndaj dhe të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre në përputhje me këto dokumenta. Sasia është një element i rëndësishëm i preventivit të ofertës ekonomike për procedurën objekt prokurimi, përveç faktit që është një element i detyrueshëm i përcaktuar në DST nga autoriteti kontraktor, modifikimi i tij përbën mospërgatitjen e ofertës sipas përcaktimeve të dhëna në dokumentat e tenderit, duke e kthyer ofertën ekonomikë në një ofertë të pavlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Këtë gjykim KVO e bazon dhe në vendimin e KPP i cili është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat, ankandeve publike dhe procedurave konkurruese të dhënies së lejeve minerare, organ i krijuar me ligjin 10 170, datë 22.10.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”.

## **K.P.P. 550/2020**

- II.** Punonjesi F.Billa figuron i deklaruar në dy vende në shtojcën 8 të vetëdeklarimit, hidroizolues dhe specialist i tavaneve të varur pra nga 28 punonjës total janë paraqitur 27.
- III.** Në pikën **2.3.10** të DST për pajisjet artikulli 3, “Njesi e brendshme+e jashtme split e peshtatshme per dhoma frigoriferik, kapaciteti ne ftohje 3.0kW, prurja e ajrit Vmes=2167m3/h” nuk është paraqitur autorizim nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar.

- IV. Vilson Dhima, i cili ka autorizuar operatorin S I R E T A 2F, nuk ka autorizim të dokumentuar nga prodhuesi DORIN/RIVACOLD gjë e cila e bën të pamundur vërtëtimin e mardhënieve ndërmjet prodhuesit dhe distributorit dhe e bën të pa sigurtë realizimin e kësaj kërkesë. Sipas DT përcaktohet:

*2.3.11.a Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.10, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje.*

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik” neni 92 pika 3:

**3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.**

Për sa më lart oferta e operatorit ekonomik **Sireta 2F shpk** nuk kualifikohet

- 
5. **BOE Braka Construction shpk me NIPT L61906505I** dhe adresë Durrës Ndertim objekt multifunksional 10 katesh, 8 kate banim + 2 sherbimi dhe 1 kat nentoke, lagjja Nr.5, Rr.Hajdar Dushi, ish Parku Sportiv, perballe shkolles Marie Kaçulini, ndodhur ne kryqezimin e rruges Mujo Ulqinaku me rrugen Andon Naçi dhe Hajdar Dushi **si dhe SARDO shpk me NIPT K13120402W** dhe adresë Fier Lagjja Apollonia, Rruga Jakov Mile, Z. Kadastrale 8534, Nr. Pasurise 3/5-N12, me vlerë 110,979,311.49 lekë pa tvsh **përfaqësues i BOE me prokurë Braka Construction**

#### **Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- I. OE Sardo sipas shtojcës 8 deklaron që ka dhënë ofertë të pavarur dhe pa u konsultuar.
- II. Nga shqyrtimi I dokumentacionit, rezulton se operatorët ekonomikë nuk kanë bërë një ndarje të punëve që do të realizojë secili.

Kjo në kundërshtim me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, KREU XI, KUSHTE TË PËRGGJITHSHME PËR ZBATIM, Bashkimi i operatorëve ekonomikë, Neni 88, pika 1:

1. *Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet*

*pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.*

- III. Operatori ekonomik Braka pikën e licencës të kërkuar NP3 – C e ka NP – 3A
- IV. Operatori Sardo pikën e licencës të kërkuar NP – 3C e ka NP – 3B
- V. Operatori Sardo pikën e licencës të kërkuar NS-4C e ka NS-4A
- VI. Operatori ekonomik Sardo nuk ka paraqitur vërtetimin e xhiros për tre vitet e fundit kjo në kundërshtim me pikën **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar** të DT.
- VII. Operatori ekonomik Braka si realizim punë të ngjashme ka paraqitur dokumentacionin 9)\_PUNE\_E\_NGJASHME\_1\_BRAKA\_B\_KUKES\_9\_MIL ku ky operator është nënkontraktor.

Sipas pikës **2.3.2** të DT ky operator duhet të paraqiste edhe:

*Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor (NE RAST SE KA QENE E PERCAKTUAR NE KONTRATE MIRATIMI).*

Për rrjedhojë kjo punë nuk do të meret parasysh.

- VIII. Operatori ekonomik Sardo ka paraqitur për punë të ngjashme vetëm kontratën 295/2 datë 30.06.2020 “Rikonstrukcioni i Godinës së vjetër dega e doganës Vlorë.pdf” realizuar nga ky operator si pjesë e BOE në vlerën 90% pra nga një total prej 31,759,878.00 leke. Për rrjedhojë operatorit Sardo i takon vlera 30,171,884.10 lekë.

Sipas përqindjes së bashkëpunimit, në rastin më të mirë, operatori Sardo duhet të kishte të realizuar punë të ngjashme në vlerën 40% të shumës 79,486,197.51 pra:

$$79,486,197.51 \times 40\% = 31,794,479.00 \text{ lekë}$$

Me dokumentacionin e paraqitur ky operator ka të realizuar punë të ngjashme në vlerën **30,171,884.10 lekë**, që në asnjë rast nuk e plotëson kriterin për punë të ngjashme.

Për rrjedhojë ky kusht nuk plotësohet nga ky operator.

- IX. Për pajisjet e pikës **2.3.11.b** të kërkuara në DT nuk është paraqitur asnjë katalog. Kjo në kundërshtim me pikën 2.3.11.b të DT e cila citon:

*2.3.11.b Të paraqiten katalogët për të gjitha pajisjet sipas pikës 2.3.10. Katalogët duhet të paraqiten në formë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al). Në katalogë, duhet të markohet me*

*ngjyrë të verdhë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje. Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.*

- XI.** Operatori ekonomik BRAKA ka deklaruar vetem një inxhinier ndërtimi ndërsa dy punonjësit e tjerë vetëm me emertimin INXHINIER, pa specifikuar profiling e inxhinierëve.

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik” neni 92 pika 3:

**3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.**

Për sa më sipër oferta e **BOE Braka shpk & Sardo shpk** nuk kualifikohet.

- 
- 6. KEVIN KONSTRUKSION shpk me NIPT K71401004W** dhe me adresë Tiranë Rruga Adem Jashari, Ndertesa 4, Hyrja 10, Njesia Bashkiake Nr.5, me vlerë 113,243,735.40 lekë pa tvsh

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- I.** Operatori ekonomik për plotësimin e kritërit **2.3.8** të DT ka paraqitur dokumentacion për certifikatat: EN-ISO 9001:2015, EN-ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 lëshuar nga AQScert. Certifikatat EN-ISO 9001:2015, EN-ISO 14001:2015 I kanë të specifikuar se datat e skadencës janë përkatësisht EN-ISO 9001:2015 më datë 04.02.2022 dhe EN-ISO 14001:2015 më datë 25.11.2021.  
Këto certifikata në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit kanë qene të pavlefshme dhe për rrjedhojë nuk mund të meren parasysh nga KVO.

Kjo bazuar në kriteret e kërkuara si dhe në vendimet e KPP përkatësisht **K.P.P. 18/2021** pika III.1.10. i cili gjykon:

*...Sa më lart, dokumenti i paraqitur nga operatori ekonomik “\*\*\*\*\*” sh.p.k. do të konsiderohet i parregullt, pasi është një dokument i pavlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit, duke mos plotësuar kështu të gjitha kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor. Pra, operatori ekonomik ankimes “\*\*\*\*\*” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur, nuk plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën \*\*\*\*\* të kritereve të veçanta të kualifikimit.....*

Gjithashtu paraqitja e këtyre dokumentave është në kundërshtim me pikën 2.3.8 të DT:

**2.3.8 Shoqeria duhet te paraqesë Certifikatat e cilësisësi me poshtë:**

- a. *Certifikatën e cilesisë së punimeve **ISO 9001-2015 (e vlefshme)**/ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
- b. *Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015 (e vlefshme)**. /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

**II. Operatori ekonomik për plotësimin e kriterit për punë të ngjashme, ka paraqitur dokumentacion për kontratat:**

- 7)\_KEVIN\_PUNE\_E\_NGJASHME\_UAM\_BAZA\_763\_mil\_MINISTRIA\_E\_SHNDETESIS
- 8)\_KEVIN\_PUNE\_E\_NGJASHME\_RRUGE\_FSHZH\_53\_mil\_MINISTRIA\_E\_SHNDETESIS
- 9)\_KEVIN\_PUNE\_E\_NGJASHME\_R.\_B.T\_NDROQI\_25\_MIL\_MINISTRIA\_E\_SHNDETESIS
- 10)\_KEVIN\_PUNE\_E\_NGJASHME\_UAM\_SISTEMET\_44\_mil\_MINISTRIA\_E\_SHNDETESIS

**Nga ku:**

- 7)\_KEVIN\_PUNE\_E\_NGJASHME\_UAM\_BAZA\_763\_mil\_MINISTRIA\_E\_SHNDETESIS

Për këtë punë është paraqitur kontrata bazë me prot, 910/6 datë 24.01.2013 e cila është jashtë afatit të 5 viteve të fundit.

Po për këtë objekt ka një kontratë shtesë ne vlerën 17.7% me prot, 58/1 datë 14.01.2016 e cila edhe kjo është jashtë afatit prej 5 vjet.

Në vijim të kësaj shtese kontrate ka një kontratë shtesë 2.20% prot, 1292 datë 29.12.2016.

Bazuar në kontratat, faturat dhe preventive, vetem kjo shtesë kontrate do të meret në konsideratë.

- 8)\_KEVIN\_PUNE\_E\_NGJASHME\_RRUGE\_FSHZH\_53\_mil\_MINISTRIA\_E\_SHNDETESIS

Është realizim rruge e cila është jashtë objektit të prokurimit që AK do të realizojë dhe për rrjedhojë nuk konsiderohet punë e ngjashme.

- 9)\_KEVIN\_PUNE\_E\_NGJASHME\_R.\_B.T\_NDROQI\_25\_MIL\_MINISTRIA\_E\_SHNDETESIS

Nga dokumentacioni I paraqitur, vërehet se operatori ekonomik Kevin ka një % prej 80.61% të fondit për këtë punë, pra me një vlerë prej 1,013,717.28 **lekë**.

Për sa më lart operatori ekonomik nuk ka asnjë punë që të realizojë kushtin **2.3.1/a** të DT, pra një punë të vetme e cila të jetë sa 50 % e fondit limit **79,486,197.51 lekë**.

Për të realizuar këtë kriter ky operator duhet të ketë një shumatorë të punëve të gjashme më një vlerë sa dyfishi I fondit limit pra **317,944,790.04** leke.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ky operator arrin një shumë prej **98,805,165.28** lekë nga **317,944,790.04** lekë që duhet të kishte.

Për rrjedhojë ky kriter nuk plotësohet nga ky operator.

**III.** Për pajisjet e pikës **2.3.10.** të DST operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion përveç deklaratës së pajisjeve (as katalogë, as autorizime). Kjo në kundërshtim me kriteret e vendosura në DT ku cilësohet:

*2.3.11.a Për pajisjet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.10, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje.*

*2.3.11.b Të paraqiten katalogët për të gjitha pajisjet sipas pikës 2.3.10. Katalogët duhet të paraqiten në formë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al). Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të verdhë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje. Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.*

**IV.** Drejtuesit teknik të deklaruar nga operatori ekonomik janë të dy punësuar:

- Z. B. Ismaili, rezulton i punësuar në Albanian Highway Concession, me numër NIPT-I L62427021G

*Me objekt: “Zbatimi dhe permbushja e kushteve të Kontrates së Koncesionit Nr.2584 Rep. datë 06.12.2016 të lidhur midis Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturas “Autoriteti Kontraktues” dhe Koncesionarit, me objekt ndertimin, përmirësimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rruges Milot – Morinë....”*

- Znj. E. Shakaj, rezulton i punësuar në ALVISION, me numër NIPT-I L01423012C

*Me objekt: “.....Zbatim për punimet e restaurimit të monumenteve dhe arkitektures për shoqëri ndertimi.”*

Kjo në kundërshtim me vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushetrojnë Veprimtari Ndërtimi”, KREU IV Drejtuesi Teknik i Shoqërisë dhe Papajtueshmëria me Këtë Detyrë,



2. Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit **Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike.**

**Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi** dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit

Kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik” neni 92 pika 3:

**3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.**

Për sa më sipër oferta e **KEVIN KONSTRUKSION shpk** nuk kualifikohet.

-----

7. Euro ndertimi 2000 shpk me NIPT K02003001O dhe me adresë Tiranë Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, Pallati 114, Shkalla 1, Kati 2, Apartamenti 2, me vlerë 118,426,442.00 lekë pa tvsh

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- I. Z. E. Muçaj, drejtues teknik dhe i deklaruar që do të jetë në kantier është i punësuar pranë MET-ENGINEERING, me numër NIPT-i L52025007R,

